

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1987/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me sekretaren juridike Ganimete Krasniqi, procesmbajtëse në çështjen penale, kundër të pandehurës **F.Z.**, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.2546/2014, të datës 22.09.2014, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.01.10.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Besart Mustafa dhe të pandehurës, në bazë të nenit 366 të KPP të Republikës së Kosovës, të njëjtën ditë mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura: F.Z., nga i ati M. dhe e ëma H., e vajzërisë S.1, i lindur me ..., në S.2, me vendbanim në P. në rr. “M.F.” rruga ..., banesat e R., Hyrja ..., kati ..., ka të kryer fakultetin, e martuar, e pa punë, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Me datën 07.03.2014, rreth orës 18:00, në rrugën “E.Q.”, në P., e pandehura posa ka hyrë në lokalin “A.”, është ulur në një tavolinë dhe i është drejtuar të dëmtuarës N.H. me fjalët “a po më njeh, mos u bën mangup, qka po i qon vetullat”, dhe papritmas ka filluar ta sulmoj ashtu që fillimisht është afruar pranë tavolinës ku ka qenë e ulur e dëmtuara, kinse për të biseduar e pastaj me dashje e duke e përdorur forcën e ka sulmuar duke ia tërhequr duart dhe flokët,

-me këtë ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 41; 43; 46; dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 248; 359 dhe 365 të KPPK –së, të pandehurës F.Z. i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **300 (treqind) €**, të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në mënyrë vullnetare nga ana e te pandehurës, atëherë Gjykata dënimin me gjobë në shumën prej 300 (dyqind) Euro, do ta shndërroj në dënim me burg duke i llogaritur 20 Euro të gjobës për një ditë burg.

Obligohet e pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale -paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **tridhjetë (30) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara: N.H. nga Gj., për realizimin e të drejtës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.2546/2014, të datës 22.09.2014, e ka akuzuar F.Z., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datën 01.10.2018, gjatë së cilës seancë u dëgjuan prokurori i shtetit dhe e pandehura.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 01.10.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, e pandehura F.Z., ka deklaruar se e ka kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe ndjehet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria e Shtetit, i vjen keq për rastin që ka ndodhur, dhe është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit Besart Mustafa, lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura ka deklaruar se, meqë e pandehura e pranoi fajësinë në përputhje me dispozitat e nenit 248 të KPRK-së, dhe pranimi i fajësisë është me përputhje të plot me provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga e pandehura gjykata në bazë të nenit 248 par.4 të KPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga e pandehura pasi që është bindur plotësisht se e pandehura ishte e vetëdijshme për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se e pandehura e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e saj të plotë.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaratimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga e pandehura, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës F.Z. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe të njëjtën e shpalli fajtorë, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjëse.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: e pandehura e ka pranuar fajësinë, është penduar, dhe është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, me bindje se kjo është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e

kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1987/14, dt.01.10.2018.

Procesmbajtëse,
Ganimete Krasniqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Lumnije Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.